

PROJEKTET E VIJUESHMËRISË - THIRRJA E 4
GRANTMARRËSIT: ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE

Nr.	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
1	Eco-Albania (Qendra për Ruajtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri)	Angazhimi i komunitetit - Tregues i integritimit në vendimmarrjeve AKTIV - II	Projekti synon të përmirësojë legjislacionin kombëtar për koncesionet e HEC-eve në Shqipëri. Objektivat kryesorë janë: të nxisë nismën e shoqërisë civile për përmirësimin e legjislacionit për koncesionet e HEC-eve në Shqipëri si dhe të llobojë dhe advokojë në nivel komunitar, qeverisës, ligjor, legjislativ dhe politik për përmirësimin e legjislacionit për koncesionet e HEC-eve në Shqipëri.	14	Bashkitë Tiranë, Kukës, Tepelenë, Shkodër, Përrenjas
2	Instituti Shqiptar i Shkencave	Monitoro klientë të Bashkive në kontrata publike	Projekti synon të nxisë individët dhe grupet të bëjnë vlerësim dhe reagim qytetar (gazetar, aktivist, grupe interesi) mbi situata të parregullta të kontraktimit dhe efikasitetit të kontratave publike për punë, furnizime apo shërbime publike. Objektivat kryesorë janë: aplikimi i instrumenteve që lehtësojnë gjetjen, përdorimin dhe vizibilitetin e informacionit mbi shpërndarjen e kontratave publike sipas kontraktorëve/klientëve; rritje e kapacitetit të aktivistëve dhe gazetarëve lokalë në vlerësim dhe reagim mbi shpërndarjen (përqëndrimin) e kontratave publike sipas klientëve si dhe identifikim i shpërndarjes së kontratave publike (parasë publike) në klientë sipas grupit gjinor.	15	Kombëtare
3	Forumi i Mendimit të Lirë	Advokimi dhe nxitja e qytetarëve dhe medias, për të marrë pjesë në qeverisjen vendore dhe llogaridhënien e saj, për të ushtruar presion në realizimin e premtimeve elektorale	Projekti synon të nxisë dhe advokojë qytetarët për të kërkuar nga bashkia zgjidhjen e problemeve emergjente dhe realizimin e premtimeve elektorale. Objektivat kryesorë janë: ballafaqimi i 8 bashkive në vitin e fundit të mandatit me shkallën e realizimit të premtimeve elektorale të kryebashkiakëve të tyre gjatë fushatës elektorale si dhe të nxisë dhe advokojë reagimin qytetar, për zgjidhjen e 10 çështjeve konkrete në 10 njësi administrative, duke bashkëpunuar edhe me gazetarët lokalë.	12	Bashkitë Tiranë, Elbasan, Krujë, Gramsh, Lezhë, Mat, Vlorë, Selenicë

4	Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome/Një Zë i Barabartë Rom & Egjiptian	Aktivizëm qytetar për lobim dhe advokaci për problemet e strehimit dhe bursave të studimit për komunitetet rome dhe egjiptiane në Bashkinë Elbasan dhe Vlorë	Projekti synon të informojë, sensibilizojë, mbështesë dhe mobilizojë qytetarët e bashkisë së Elbasanit dhe Vlorës për të siguruar aksesin dhe përfshirjen aktive në vendimmarrjen e këshillit bashkiak. Objektivi kryesor është të mobilizojë 100 familjet e interesuara në bashkinë e Vlorës dhe Elbasanit për aplikim për Bonus Strehimi si dhe mobilizimi i nxënësve dhe prindërve nga komuniteti rom dhe egjiptian për të advokuar së bashku me aktivistët për përfitimin e bursave të studimit në bashkitë e Elbasanit dhe Vlorës.	12	Bashkitë Elbasan dhe Vlorë
5	Together for Life	Rrjeti “Lëviz për Kopshtin tim”	Projekti synon të mobilizojë dhe të fuqizojë prindërit, opinionin publik dhe organizatat lokale për të rritur llogaridhënien dhe transparencën në nivel vendor në bashkitë e përzgjedhura. Objektivat kryesorë janë: hartimi i një raporti monitorues statistikor të gjetjeve gjatë monitorimit të standarteve fizike të kopshteve në bashkitë e përzgjedhura; informimi dhe edukimi i qytetarëve përmes publikimeve në media dhe komunikimeve mediatike.	12	Bashkitë Pogradec, Sarandë, Delvinë, Tiranë
6	Infinit +	Pushtetari përballë qytetarit	Projekti synon të përballë qytetarët dhe përfaqësuesit vendorë me problemet që ata kanë në forume publike ku do të marrin pjesë vetë banorët, si dhe përfaqësuesit e Njësive Administrative/Bashkisë së Tiranës. Objektivi kryesor është të rritet llogaridhënia e pushtetit vendor në lidhje me qytetarët si dhe të përmirësohet transparenca e investimeve duke i përballur pushtetarët e Njësive Administrative jo vetëm me banorët por edhe me presionin e medias.	12	Bashkia Tiranë

PROJEKTET E VIJUESHMËRISË - THIRRJA E 4^{të}
GRANTMARRËSIT INDIVIDË

Nr.	Individi	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
7	Diana Malaj	Qyteti i maskave	Projekti synon të nxisë pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrjen lokale, nëpërmjet metodave joformale (teatër, ushtrime artistike dhe ndërhyrje në hapësira publike) për të përfshirë në buxhetin e vitit 2019 të Bashkisë Kamëz një listë kërkesash qytetare me fokus politikat social-kulturore. Objektivat kryesorë janë: identifikimi i problematikave të qytetarëve të Kamzës nëpërmjet Forumit të Atyre si dhe të advokojë nëpërmjet artit për përfshirjen e 10 prioriteve të qytetarëve në buxhetin e Bashkisë Kamëz 2019.	12	Bashkia Kamëz
8	Gentjan Hajdari	Luaj për demokracinë	Projekti synon që përmes angazhimit rinor në sport dhe art, Bordi Rinor Vorë të advokojë në Bashkinë e Vorës që të buxhetohen aktivitete rekreative për të rinjtë dhe të hapen më shumë hapësira rekreative për ta. Objektivat kryesorë janë: informimi përmes aktiviteteve sportive dhe artistike i rreth 150 të rinjve për të drejtat e tyre në demokracinë vendore nga anëtarët e Bordit Rinor Këshillimor Vorë; advokimi për hapësira dhe aktivitete rekreative për të rinjtë e Vorës në buxhetin e vitit 2019.	11	Bashkia Vorë